



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
Nr.01-060/01-25892/24 datë: 19.09.2024



Npi - 01/302 datë: 19.09.2024

Bazuar në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr.28, datë 04.06.2008); Nenit 32, dhe 37 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës Nr.02/2015 të datës 28.12.2015; Si dhe në bazë të nenit 4 dhe 6 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 të datës 27.04.2023, Kryesuesi i Kuvendit vendosi të bëjë këtë:


**F T E S Ë**

**PËR MBLEDHJEN E -IX- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES**

E cila do të mbahet në sallën e Kuvendit më: 27.09.2024 (e premte) Në ora: 09:00h

**R E N D I T E**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 30.08.2024,
2. Plani-Buxhetor i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (pas diskutimit publik),
3. Raporti Periodik për zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023,
4. Propozim - Vendim për fshirjen e obligimeve Tatimore të AKP-së ndaj Komunës së Shtimes,
5. Propozim - Vendim për miratimin e shkallës tatimore progresive për vitin 2025,
6. Propozim-Vendim për ndarjen e parcelës për objektet e banimit të përbalueshëm dhe social,
7. Informatë nga DSHP-ja lidhur me përgatitjet dimërore, dhe menaxhimin e mbeturinave, dhe furnizimin me ujë,
8. Pyetje – Përgjigje.



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO




KOMUNA SHITIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHITIME



Drejtoria për Shërbime Publike  
Uprava za Javne Službe/Directorate of Public Service

Data/Datum/Date:	20.09.2024
Nr.Br.No:	08/64
Për/ Za/To:	Sekretaria e Kuvendit Komunal në Shtime
Përmes/Preko/Through:	Drejt përdrejtë
Nga/Od/From:	Drejtori për Shërbime Publike: <b>Bardhyl Priziti</b>
Lënda/ Predmet/Subject:	Informatë për menaxhimi e mbeturinave të përgatitura dimërore



Të nderuar,

Drejtoria për Shërbime Publike ju njofton se gjatë vitit 2023-2024, kompania "Pastërtia" ka shënuar ngritje në ofrimin e shërbimeve për qytetarë në menaxhim të mbeturinave si rezultat i mekanizmit të ofruar nga Qeveria Japoneze dhe GIZ-it Gjerman. Problemet kanë qenë ma të theksuara gjatë periudhës Verore ku sasia e mbeturinave është rritur pothuajse njëqind për qind. Mirëmbajtjes së pastërtisë në qytet i ka kontribuar edhe kompania e kontraktuar nga Komuna e cila në vazhdimësi është kujdesur për hapësirat publike sipas kontratës Nr.617-24-1535-2-1-1 datë:02.05.2024.

Bazuar në raportimin vjetor për menaxhim të mbeturinave në AMMK është bërë edhe evidentimi i deponive ilegale ku gjithësej janë 11 deponi. Janë eliminuar disa prej tyre të evidentuara si deponi të mëdha nga operatori i kontraktuar nga komuna sipas kontratës Nr.03/1/109 datë:24.10.2023 por problematika vazhdon edhe pse intervenimet nuk kanë munguar.

Sfidë vazhdon të mbetet menaxhimi i mbeturinave inerte në mungesë të lokacionit të përshtatshëm për hudhjen e tyre.

**Sezoni dimëror:** ju informojm se është kontraktuar kompania për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve kontratë kornizë 24 muaj me nr.617-23-10510-2-2-1 datë:15.11.2023 në të cilën janë të specifikuar të gjitha shërbimet që do të ofrohen nga operatori gjatë sezonit dimëror.

Drejtoria për Shërbime Publike është e gatshme për çdo lloj intervenimi në çdo kohë varësishtë problematikave që hasën në teren.

Të dhënat që i kemi nga KRU Prishtina për gjendjen me furnizim me ujë po i japim në mënyrë tabelorë për secilin vendbanim, që nuk ndryshon nga raportet e mëhershme. Nevojat për rritje të kapaciteteve të ujit janë të domosdoshme dhe këto mund të bëhen vetëm me bashkëpunim të ndërsjellët ujësjellës, komuna dhe konsumator të cilët duhet të paguajnë ujin e shpenzuar

QVA  
ILJE



KAF  
KOS  
MES  
SI

Nr.	Emertimi i vendbanimit	Vërejtje
<b>SISTEMI I UJËSJELLËSIT NË SHITIME</b>		
1.	Shtime	I gjithë qytetit ka furnizim 24 orë në ditë
2.	Petrovë	Në mungesë të kapaciteteve të ujit dhe mos vendosjes së ujëmatësve nuk ka mundësi të furnizohet
3.	Raçak	Në mungesë të kapaciteteve të ujit dhe mos vendosjes së ujëmatësve nuk ka mundësi të furnizohet
4.	Mollopolc	Në mungesë të kapaciteteve të ujit dhe mos vendosjes së ujëmatësve nuk ka mundësi të furnizohet
5.	Lagje e Pajtimit	Furnizimi 24 orë përveç në disa kuota më të larta ku ka shtypje të vogël dhe furnizim të pjesërishtëm. vetëm gjatë muajve të verës.
6.	Godanc i Ulët	Furnizim jo rregullt me ujë
7.	Godanc i Epërm	Furnizim jo rregullt me ujë
<b>SISTEMI I UJËSJELLËSIT TË FSHATRAVE TË RRAFSHIT</b>		
1.	Rashincë	Furnizimi 24 orë përveç në disa kuota më të larta ku ka shtypje të vogël vetëm gjatë muajve të verës :Qershor, Korrik dhe Gusht
2.	Vojnovc	Furnizimi 24 orë përveç në disa kuota më të larta ku ka shtypje të vogël vetëm gjatë muajve të verës :Qershor, Korrik dhe Gusht
3.	Gllavicë	Furnizimi 24 orë përveç në disa kuota më të larta ku ka shtypje të vogël vetëm gjatë muajve të verës :Qershor, Korrik dhe Gusht
4.	Muzeqinë	Furnizimi 24 orë përveç në disa kuota më të larta ku ka shtypje të vogël vetëm gjatë muajve të verës :Qershor, Korrik dhe Gusht
5.	Davidovc	Furnizimi 24 orë përveç në disa kuota më të larta ku ka shtypje të vogël vetëm gjatë muajve të verës :Qershor, Korrik dhe Gusht
6.	Gjurkovc	Furnizimi 24 orë përveç në disa kuota më të larta ku ka shtypje të vogël vetëm gjatë muajve të verës :Qershor, Korrik dhe Gusht
<b>SISTEMI I UJËSJELLËSIT TË FSHATRAVE MALORE</b>		
1.	Carraleva	Pjesërisht në pjesën e poshtme te fshatit gypi është i dëmtuar
2.	Belinci	Nuk furnizohet gypi ekzistues i dëmtuar
3.	Zborci	Nuk faturohet dhe nuk furnizohet
4.	Pjetreshtica	Nuk faturohet dhe nuk furnizohet
<b>Sistemi i fshatit Rancë</b>		
1.	Ranca	Nuk menagjohet

Duhet theksuar se në mungesë të investimeve të cilat janë të domosdoshme të bëhen duke e llogaritur edhe zgjerimin e vendbanimeve dhe rritjen e konsumatorëve në të njëjtën kohë edhe zvogëlimin e kapaciteteve prodhuese të burimeve të tanishme duhet të ndermirren masa që të gjinden mundësitë për rritje të kapaciteteve. Në bashkëpunim me Komunën, KRU "Prishtina" sha dhe donatorë të janë dhënë disa alternativa të cilat do të zgjidhnin problemin e ujit të pijes për një periudhë të gjatë. Por si më urgjente do të ishte zgjerime i kapaciteteve

e ujit të pijes për një periudhë të gjatë. Por si më urgjente do të ishte zgjerime i kapaciteteve prodhuese të ujit të burimet në Rashincë dhe integrimi i të dy Sistemeve në mes vete. Shpresojmë se deri te një zgjidhje do të vijmë shumë shpejtë, sepse Komuna, KRU "PRISHTINA" sh.a dhe Qeveria e Kosovës janë në implementim të projektit. Vlera e Projektit pritet të jetë mbi 300,000.00 Euro.

Faktori kryesor që më së shumti po ndikon në orientimin e investimeve në zgjerimin e kapaciteteve në Rashincë është:

1. Nuk ka probleme pronësore Juridike
  2. Kapaciteti i burimeve më i madh
  3. Kualiteti i ujit për shkak se në atë zonë nuk ka vërshime apo rrjedhe të ndonjë lumi apo proçkë që do ta rrezikonte nga përmytjet nga uji.
  4. Infrastruktura ekzistuese duke u nisur nga rruga, rrjeti elektrike etj që janë faktorë kryesor për një veprimtari normale dhe pa shpenzime shtesë. (Projekti ka filluar të realizohet ku janë të planifikuar hapja e dy puseve , Stacioni për grumbullim dhe trajtim të ujit si dhe rrjeti në gjatësi rreth 5 km ku do të ndërlihen sistemet në mes veti)
- Ndërsa te pusët në Shtime ende nuk i kemi të zgjidhura Problemet Pronësore Juridike me pronarët e tokave dhe nuk mund të llogarisim në hapjen e puseve të reja. Mungesa e te reshurave atmosferike dhe temperaturat e larta gjatë muajve te fundit na e kanë vështirësuar furnizimin e rregullt me ujë.
- Sa i përket Kualitetit të ujit nuk kemi probleme dhe analizat e ujit janë të përditshme sa i përket sasisë së klorit dhe turbulentët e ato kimike-bakteriologjike dy herë në javë nga IKSHP dhe Laboratori Qendror në KRU "PRISHTINA" sha e në rast nevojë kur dyshohet në ndonjë faktorë i cili do të ndikonte në kualitetin e ujit sidomos kur ka të reshura të mëdha të shiut edhe më shpesh. Për kualitetin e ujit i IKSHP e merr vendimin primar sa i përket vlerësimit.

Tani në Shtime dhe vendbanimet tjera që i furnizojmë me ujë numri i konsumatorëve është 4000 apo përafërsisht rreth 88 % e banorëve të komunës.

Edhe sa i përket furnizimit me ujë të fshatit Pjetërshiticë dhe Zborc janë hartuar projektet dhe pritet të filloj implementimi i tyre.

---

Adresa: Rr. Tahir Sinani nr 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.  
Tel.: +383290389016 ex 227 email: info@shtime-komuna.org  
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
Direktorat za Budžet i Finansije

Data/Datum/Date:	20.09.2024
Nr./Br./No	11/173
Për/Za/To:	Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendin Komunal Shtime
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komitetit
Nga/Od/From:	Besnik Ahmeti- Drejtor Buxhet Financa Bujar Ferati, Menaxher i Pajtim
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim - Vendim për përfundim të obligimeve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)

Të nderuar/a

Bazuar në Raportin e auditimit për pasqyrat financiar për vitin 2023 dhe gjetjen: A1 Prezantim jo i plotë dhe i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF në vlerë prej 15,500€ ku sipas nenit 6 të Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Sipas nenit 7 Paragrafi 2.6.2 i shtojcës së Ligjit Nr. 04/I-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), pjesa II Procedurat Fillestare parasheh njoftimin që: "Përfshin një deklaratë të qartë se të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interesa ndaj ndërmarrjes apo asetëve të ndërmarrjes duhet të parashtrijnë Dëshmi të Kërkesës dhe/apo Dëshmi të Interesit me anë të formularit përkatës bashkë me të gjitha dokumentet mbështetëse brenda Afatit për parashtrimin e kërkesave, që do të caktohet në 16:00 në një ditë pune dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është publikuar në tërësi Njoftimi për likuidim në pajtim me të gjitha kërkesat e aplikueshme të Dispozitave për Shpallje".

Lista e ndërmarrjeve për të cilat nuk janë respektuar afatet kohore për parashtrimin e kërkesave kreditore me rastin hyrjes së Ish Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim nga Agjencia e Kosovës për Privatizim (AKP).


Të bashkangjitur gjeni listën :

Lista e ndërmmarrjeve të regjistruara në menaxhim të APK-së

Emri Tatimpaguesit	Adresa	Nr Faturës	Shuma -Obligimi	E privatizuar/Proces
1 N.SH. TREGËTIA	Shtime	1227	16,129.38	Po
2 N.SH. KOPERATIVA BUJQËSORE	Shtime	1226	9,404.42	Po
3 N.SH AGROQNDRRA SHTIME	Shtime	12220	6,580.78	Po
4 N.SH. KOPERATIVA BUJQËSORE	Muzeqinë	12218	3,573.24	Po
5 N.SH. HOTEL LYBETENI FERIZAJ	Shtime	1222	3,829.86	Po
6 N.SH 17 NËNTORI	Shtime	1223	2,410.07	Në proces 09.09.2013
7 N.SH.K PEMISHTE	Shtime	12222	1,706.30	Po
8 N.SH 17 NËNTORI	Muzeqinë	12216	1,502.75	Në proces 27/06.2013
9 N.SH. PASURI BUJQESORE	Petroviq	12213	953.66	Po
10 N.SH. SH. A. MAGJISTRALJA	Shtime	12214	25.75	Po
Totali			46,116.21	



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
Direktorat za Budžet i Finansije

Data/Datum/Date:	20.09.2024
Nr./Br./No	11/175
Për/Za/To:	Komiteti për Politikë dhe Financa Kuvendin Komunal Shtime
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komiteteve
Nga/Od/From:	Besnik Ahmeti- Drejtor Buxhet Financa Bujar Ferati, Menaxher Tatim në Prone
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim - Vendim për Aprovimin e Shkallës Tatimore Progressive për vitin 2025 .

Të nderuar/a

Bazuar në Ligjin Nr.08/L224 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 06/L005 për Tatimit në Prone , Drejtoria për Buxhet dhe Financa propozon Vendimin për Aprovim sipas nenit 9 Shkalla Tatimore Progressive për vitin 2025.

1. Tatimi në pronën e paluajtshme bazohet në vlerën e vlerësuar të paluajtshmërisë së tatimpaguesit si bazë tatimore në komunën përkatëse.
2. Baza tatimore për tatimpaguesin me prona të paluajtshme brenda një komune përcaktohet si bazë e vetme tatimore sipas vlerës së kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit.
3. Vlera e detyrimit tatimor llogaritet sipas kufijve në vijim:
  - 3.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.10% deri 1%;
  - 3.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.20% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafi 3.1 të këtij neni;
  - 3.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.30% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni;
  - 3.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.40% deri 1%, plus tatimi nga nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni; dhe
  - 3.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.50% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4 të këtij neni.

Propozimi:

1. Vlera pronave deri	100,000.00 shkalla tatimore	0.10%
2. Vlera pronave mbi	100,000.00 shkalla tatimore	0.20%
3. Vlera pronave mbi	500,000.00 shkalla tatimore	0.30%
4. Vlera pronave mbi	1,000,000.00 shkalla tatimore	0.40%
5. Vlera pronave mbi	5,000,000.00 shkalla tatimore	0.50%



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
Direktorat za Budžet i Finansije

Data/Datum/Date:	19.09.2024
Nr./Br./No	11/172
Për/Za/To:	Kuvendin Komunal Komitetin për Politikë dhe Financa
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Besnik Ahmeti-Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Kimete Ukaj, Zytare Kryesore Financiare
Lënda/Predmet/Subject :	RAPORTI PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PER VITIN 2023

Është nderuar,

Bazuar në Rregulloren e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit të nxjerrur nga Ligji 05/L-055, neni 14- Plani i veprimit dhe njoftimi periodik lidhur me rrjedhën e zbatimit të tij ku thuhet se pas hartimit të planit të veprimit entiteti i audituar i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve.

Ju lutem, gjeni të bashkangjitur dokumentin:

Raporti Periodik për zbatimin e Rekomandimeve

Me respekt!



Për: Komitetin për politikë dhe financa, Kuvendin e Komunës

Nga z. Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës

Date: 20.09.2024,

Shtime

RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E  
REKOMANDIMEVE 2023  
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra  
Kombëtare e Auditimit

**Gjetjet dhe rekomandimet nga viti 2023**

Nr.	Komponent 4 e auditimit(k apitull)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtar/ët përgjegjës	Data e planifik uar e zbatimit të rekom andimit	Komente
1	A1 - Prezantim jo i plotë dhe i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF	Sipas nenit 6 të Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabel të saktë, të plotë, të azhuruar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare". Sipas nenit 7 Paragrafi 2.6.2 i shtojcës së Ligjit Nr. 04/1-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), pjesa II Procedurat Fillestare parashen njoftimin që: "Përshin një deklaratë të qartë se të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interesa ndaj ndërmarrjes apo asetëve të ndërmarrjes duhet të parashitë Dëshimi të Kërkesës dhe/apo	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidencë të plota dhe të sakta për llogaritë arkëtueshme dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PVF është i plotë dhe i saktë. Gjithashtu, Kryetari duhet të	Hapi i parë: Përpunimi i një raporti detaj për ish ndërmarrjet shqetërore të cilat menaxhohen nga AKP. Hapi i Dytë: Takimi me AKP-në dhe përgaditja dhe dorëzimi i kërkesës për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të	Drejtori për Buxhet dhe Financa Menaxheri i zyrës së Tatimit në Prorë	TM3 - TM4 2024	E zbatuar

	<p>Dëshmi të Interesit me anë të formularit përkatës bashkë me të gjitha dokumentet mbështetëse brenda Afatit për parashtrimin e kërkesave, që do të caktohet në 16:00 në një ditë pune dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është publikuar në tërësi Njoftimi për likuidim në pajtim me të gjitha kërkesat e aplikueshme të Dispozitave për Shpallje".</p> <p>Komuna në tri (3) raste ka bërë prezantim jo të plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF për 15,500€, për gabimet e hasura si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Llogaritë e Arkëtueshme nga tatimi në pronë ishin mbivlerësuar për 14,460€, pasigë komuna nuk ka ofruar dëshmi që i japin të drejtën për arketimin e këtyre njeteve. Sipas dëshmnive të siguruara nga ana jonë, AKP kishte inicuar procesin e likuidimit të N.SH. Koperativa Bujqësore Shtrime me datë 09.09.2013. Ndërsa, komuna nuk kishte bërë kërkesë për mbledhjen e tatimit në pronë brenda afatit kohor prej 45 dite nga njoftimi i AKP-së, e cila kishte paraparë afatin për pranimin e kërkesave nga data 18.09.2013 deri me 01.11.2013, gjatë kësaj periudhe komuna ka pasur afat 45 ditë për parashtrimin e kërkesave kreditore ndërsa komuna kërkesën e ka bërë me datë 27.12.2023, për çka komuna i ka humbur afatet për të parashtruar kërkesën për mbledhjen e këtyre llogarive të arkëtueshme dhe ligjërishit nuk ka të drejtë</li> </ul>	<p>sigurohet zyrtarët përgjegjës të respektojnë afatet kohore për parashtrimin e kërkesave kreditore me rasin hyrjes së Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim nga Agjencia Kosovës për Privatizim (AKP).</p>	<p>që të precizuar listën e ndërmarrjeve të cilat nuk kanë plotësuar formularin sipas nenit 7 Paragrafi 2.6.2 i shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), pjesa II Procedurat Filjestare parashoh njoftimin që: "Përftshin një deklaratë të qartë se të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interesa ndaj ndërmarrjes apo asetëve të ndërmarrjes duhet të parashtrrojnë.</p>	<p>Hapi Tretë : Procedimi i kërkesës për kuvend Komunal për nxjerrjen e</p>		
--	--	---	---	---	--	--

	<p>juridike që të kërkoi arkëtimin e këtyre mjeteve,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• llogaritë e arkëtueshme nga qiraja për shfrytëzimin e pronës komunale ishin mbivlerësuar për 1,040€.</li> </ul> <p>Kjo ka ndodh pasi që zyrtarët përgjegjës komunal nuk kanë ndërmarr veprimet për të dorëzuar kërkesën pranë AKP-së për tatimin në pronë të mbledhur ndër vite brenda afatit të përcaktuar ligjor. Si dhe, funksionimi jo efikas të kontrolleve të brendshme në azhurnimin e regjistrave kontabël dhe ruajtjen e dokumentacionit.</p>		<p>vendimit për fshirjen e këtyre obligimeve.</p> <p>Hapi Kalërt: Fshirja në programin Protax të obligimeve sipas kërkesës dhe vendimit të Kuvendit Komunal</p>		<p>TM3 - TM4 2024</p>	
<p>2</p> <p>Bl - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve</p>	<p>Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Shpenzimi i parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatese të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.</p> <p>Në shtatë (7) raste kemi identifikuar se thesari nga llogaria e komunës kishte ekzekutuar pagesa në kategori ekonomike jo adekuate në vlerë prej 232,213 E si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nga kategoria mallra dhe shërbime vlera prej 15,826€, ishte paguar për Investime kapitale, 11,750€ ishin paguar për subvencione dhe transfere dhe 64,071€ ishin paguar për paga dhe mëditje, shpenzime të ndodhura sipas kontratës kolektive.</li> </ul>	<p>Kryetari duhet të vazhdoj përpjekjet në bashkëpunim me MF për të zgjidhur çështjen e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për pagesat e parapara me kontratën kolektive në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me</p>	<p>Hapi i parë: Evidentimi i Obligimeve të cilat rrjedhin nga kontrata kolektive dhe klasifikimi i tyre ,në ato të cilat i kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe ato obligime të cilat janë në proces.</p> <p>Hapi i dytë: Trajtimi me departamentin e thesarit të kësaj teme -Obligimet kontigjente si hapja e Kodeve</p>	<p>Drejtoria për buxhet dhe Financa- ZKF Zyra Ligjore</p>		<p>Ne Process</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nga kategoria subvencione dhe transfere vlera prej 66,903€, ishte paguar për paga dhe mëdijë, shpenzime të ndodhura sipas kontratës kolektive.</li> <li>Nga kategoria e investimeve kapitale vlera prej 73,663€, ishte paguar për paga dhe mëdijë, shpenzime të ndodhura sipas kontratës kolektive.</li> </ul> <p>Pas realizimit të pagesave nga thesari, komuna kishte bërë disa kërkesa në thesar që pagesat të kryhen (regjistrohen) nga kategoria e pagave. Mëgjithtarë, këto kërkesa nuk ishin marrë parasysh nga thesari, prandaj regjistrimi i shpenzimit për këto pagesa ka mbetur i njëjtë.</p>	<p>plan kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PVF sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.</p>	<p>të reja, apo edhe rritja e buxhetit në kategorin e pagave.</p> <p>Hapi i Tretë: Përgaditja e KAB për vitin vijues dhe kodimi i mjeteve për pagesën e obligimeve të cilat kanë kaluar të gjitha proceset.</p>			
3	<p>B2 - Prezantim jo i drejtë i detyrimeve kontingjente në PVF</p>	<p>Pagesat për paga jubiliare dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet, si dhe komuna nuk kishte bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse</p> <p>Neni 6 i Rregullores MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistria kontabël të saktë, të plotë, të azhuruar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare."</p> <p>Komuna në gjashtë(6) raste, ka bërë prezantim jo të drejtë të detyrimeve kontingjente në PVF për 616,269€ për gabimet e hasura si më poshtë</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet kontingjente të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore</p>	<p>Hapi i parë; Përgaditja e një raporti detaj për obligimet kontingjente.</p> <p>Hapi i dytë: Takime me departamentin e thesarit për gjejen e mundësis për pagesën e</p>	<p>Drejtorit përkatëse ZKF</p> <p>Zyra Ligjore</p>	<p>TM3 - TM4 2024</p> <p>Ne Process</p>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyrimet Kontingjente janë mbivlerësuar për 615,143€, si shkak i prezantimit të lëndëve të cilat kanë qenë vendime gjyqësore të formës së prerë, dhe për të cilat komuna nuk kishte ushtruar ankesë në nivele më të larta.</li> <li>• Detyrimet Kontingjente janë nënvlerësuar për 1,126€, si pasojë e mos përfshijes së lëndëve me të gjitha shpenzimet e parapara për të cilat detyrohet komuna.</li> <li>Prezantimi jo i plotë dhe saktë i detyrimeve kontingjente në PVF kishte ndodhur për shkak se personat përgjegjës nuk kishin azhurnuar vlerën e detyrimeve kontingjente të prezantuar në raport e pastaj edhe në PVF</li> </ul>					
4	B3 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve dhe transferëve	<p>Sipas neni 20 të Rregullores së brendshme të komunës për ndarjen e subvencioneve Nr. 01/060/01-24495/17 i datës 16.08.2017, dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë ndër të tjera: numrin identifikues të fermerit, projektin financiar, fletë posedimit për patundshmeri, dëshmi për pagesën e taksave komunale, dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë, konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit. Gjithashtu, sipas thirrjes publike për aplikim për farë misri të datës 14.02.2023 dhe Nr. 04/05 kritere që duhet të plotësoj përfuturi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të jetë banor i Komunës së Shitimes;</li> <li>• Toka të jetë e përshatshme për kultivimin e misrit;</li> </ul>	<p>Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për forçimin e kontrollëve të brendshme në mënyrë që dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të</p>	<p>Hapi i Parë: Përgaditja e planit vjetor për ndarjen e subvencioneve.</p> <p>Hapi i dytë: Formimi i komisionit për ndarjen e subvencioneve.</p> <p>Hapi tretë: Thirrjet publike dhe specifikimi i detajuar për aplikim duke u mbështetur Rregulloren e</p>	<p>Drejtori të cilat në buxhetin e aprovuar kanë njëjtë në kategorinë e subvencioneve</p>	TM3 – TM4 2024	E Zbatuar

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aplikuesit përfitues të subvencioneve të misrit për vitin 2022 dhe</li> <li>• Aplikuesit për mbjellje deri në dy (2) ha me misër.</li> </ul> <p>Thirrja publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi për furnizim me farë misri ishte përcjell me parregullitë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Thirrja publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi nuk kishte parashikuar që aplikuesit/përfituesit të dorëzonin projekt financiarë dhe fletën poseduese për pronësi që janë tërësisht të rregullues së brendshme të komunës.</li> <li>• Një mostër e testuar kishte rezultuar që përfitues kishte dorëzuar aplikacionin me datë 09.03.2023, derisa afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve sipas thirrjes ishte 06.03.2023.</li> <li>• Sipas thirrjes publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi aplikuesit duhet të jenë përfitues të subvencioneve të misrit në vitin paraprak, pra për vitin 2022 në mënyrë që të kualifikohen për subvencionim për vitin 2023. Pra komuna kishte pamundësuar përfitimin e subvencioneve nga fermerët e rinjë.</li> <li>• Sipas thirrjes publike për aplikim për farë misri të datës 14.02.2023, me nr.04/05, ndër kriteret që duhet ti plotësoj përfituesi ishte që aplikuesit duhet të kenë për mbjellje deri në 2ha. Nga shqyrtimi i</li> </ul>	<p>komunës për subvencione. Gjithashtu duhet të sigurohet që gjatë vlerësimit të aplikacioneve të respektohen kriteret e vendosura në thirrje.</p>	<p>brendshme të komunës për ndarjen e subvencioneve.</p>			
--	--	--	--	--	--	--

	<p>dosjes për subvencionim me farë të misrit, ne kemi vërejtur se 134 përfutës nga gjithsej 198 apo 68% e tyre kishin sipërfaqe për mbjelje të misrit mbi 2ha.</p> <p>Kjo ka ndodh për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme gjatë përgatitjes së thirrjes publike dhe vlerësimit të dosjeve të aplikuesve për subvencione.</p>					
<p>5</p> <p>B4 - Mungesa e projektit ekzekutues dhe mos vendosja e tyre në platformën e-prokurimit</p>	<p>Paragrafi 19.17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tërash parashihet se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet të bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejonet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".</p>	<p>Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që mer rашin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e</p>	<p>Hapi i Parë: Kontraktimi i operatorit ekonomik për përgatitjen e projekteve detaje.</p> <p>Hapi i dytë: Procedimi me projekte për nisjen procedurave me përshkrim të hollësishëm të projektit.</p>	<p>Drejtoria e Urbanizmit Drejtoria e prokurimit Menaxheri i prokurimit</p>	<p>TM3 - TM4 2024</p>	<p>Ne Proces</p>
	<p>Në një (1) rast kemi vërejtur se komuna ka iniciuar procedura të prokurimit dhe kishite lidhur kontratë për projektin Renovimi i objekteve shërbëtesore në vlerë 59,237€ pa hartuar paraprakisht projektin ekzekutiv të ndërtimit. Po ashtu në pesë raste (5)</p>					



	<p>autoriteti kontraktues i kishite përgatitur projektet ekzekutive, por nuk i kishite bashkangjitur në platformën e-prokurimi, siç janë: Rregullimi i parkut Sheshit në qytetin e Shitimes Faza IV me vlerë 147,882€, Rregullimi i vendndalesave të autobusëve në fshatra me vlerë 68,273€, Rrethojat e fushave sportive në fshatrat Carrallevë, Petrovë dhe Davidovc me vlerë 59,168€, Rregullimi i parkut të Pishave në Shtime-Faza IV me vlerë 44,918€, Rregullimi, përmirësimi infrastrukturës në Komunën e Shitimes me vlerë 84,601€, autoriteti kontraktues i kishite përgatitur projektet ekzekutive, por nuk i kishite bashkangjitur në platformën e-prokurimi projektin ekzekutiv përkatës.</p>	<p>parashikuara si dhe të gjitha projektet ekzekutive të vendosur në platformën e-prokurimit.</p>				
	<p>Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit, duke përfshirë mungesën e hartimit të projektit ekzekutiv për projektet specifike, si dhe mungesa e kontrolleve jo adekuata për ti vendosur projektet ekzekutive në platformën e-</p>					

	<p>prokurimit. Mos bashkangjita e projekteve ekzekutive në platformen e-prokurimi, sipas zyrtareve të komunës, kishite ndodh për shkak të mos përkrahjes teknike të platformes e-prokurimi, shkaku i hapësirës së pamjaftueshme për të ngarkuar në sistem të gjitha ato materiale elektronike voluminoze.</p>				TM3 - TM4 2024	
6.	<p>A2 - Shkelje e kushteve të kontratës nga ana e shfrytëzuesit të pronës komunale</p> <p>Sipas neni 19 paragrafi 5 të ligjit 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, e drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tretë. Ndërsa sipas neni 4.8 të kontratës nr. 02/438 të dt. 30/06/2019 për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, shfrytëzuesi nuk ka të drejtë në asnjë mënyrë që ngasrën kadastrale të marrë në shfrytëzim ta bart te personi i tretë me qira apo në çfarëdo mënyrë tjetër.</p> <p>Në vendimin e datës 31.05.2019, nxjerrë nga Kuvendi Komunal është dhënë në shfrytëzim/menaxhin prona (parcela) me sipërfaqe prej 11,290m2 në zonën kadastrale Davidovc, Shitime, për ngritjen e objekteve afariste dhe ushtrimin e veprimtarisë sipas planit të biznesit, me qira vjetore prej 2,032€. Pas një ekzaminimi fizik të kësaj prone, ne kemi vërejtur se shfrytëzuesit të cilit iu kishite dhënë prona me qira, një pjesë të kësaj</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë menaxhin efikas të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, duke raportuar në raportet e tij gjashtë (6) mujore për mbikëqyjen e realizimit të kontratave nga shfrytëzuesit e pronës në raport me kushtet e përcaktuara në kontratë, në mënyrë që mos ju ipet prona palëve të treta për të cilat nuk e lejon legjislacioni në fuqi.</p>	<p>Hapi i parë: Mbjajta e një takimi informues me shfrytëzuesit e pronave komunale sipas vendimeve për shfrytëzim, dhe informimi në detaje për te drejtat e shfrytëzimit të pronës komunale.</p> <p>Hapi i dytë : Monitorimi në përhunda të caktuara për shfrytëzimin e hapësirave/prona ve dhe pregaditja e raporteve detaje për pronat të</p>	<p>Drejtorja e Ekonomisë Drejtorja e Urbanizimit dhe Katarster</p>		<p>Ne Procces</p>

	<p>prone ia kishte dhënë në shfrytëzim pa të tretë, pra kjo pronë ishte duke u shfrytëzuar nga tre (3) subjekte apo shfrytëzues të tjerë për qëllime biznesore, një barnatorë, një klinik dentare dhe një autolarje, që nuk ishin të kontraktuar/autorizuara nga komuna për shfrytëzimin e kësaj prone.</p> <p>Mungesa e vendosjes së një mekanizmi efektiv për monitorimin e procesit të pronave komunale të cilat janë dhënë në shfrytëzim ka bërë që shfrytëzuesi i kontraktuar ti pronës komunale ta jap tek palët e treta.</p>		<p>çilat janë dhënë në shfrytëzim. Hapi i tretë : Nderrmarja e masa për moszbatimin e ligjit 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale.</p>			
<p>7.</p> <p>A3 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave Jo përmes platformës së e-prokurimi</p>	<p>Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulim për menaxhimi të kontratës në sistem të prokurimit elektronik".</p> <p>Menaxherët e kontratave/projekteve nuk e kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik, menaxhinin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve.</p> <p>Kjo ka ndodh si rezultat i mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme për ta kyer këtë proces nga ana e menaxherëve të projekteve.</p>	<p>Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që i menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.</p>	<p>Hapi i parë: Zyra e prokurimit të angazhohet vazhdimisht për menaxhinin e kontratave përmes platformës E-Prokurimi. Hapi i Dytë: Kërkesa për trajtime shpesh nëse është e nevojshme për menaxhinin e kontratave përmes Platformës E-</p>	<p>Drejtorja e prokurimit Menaxheri i prokurimit</p>	<p>TM3 - TM4 2024</p>	<p>Ne Process</p>

8.	B5 - Eftikasitet i ulët në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme	<p>Sipas nenin 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme Nr. 06/L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbanuese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguarat që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe nëni 27, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjohën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitor.</p> <p>Sipas regjistrave të llogarive të arkëtueshme, vlera e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2023 ishte 530,004€. Sfidat kryesore mbetet arkëtimi i tatimit në pronë dhe atë për vliet paraprake, edhe përkundër faktit që komuna gjatë vitit 2023 kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme duke dërguar letër rikujtimin për detyrimet e papaguara tek tatimpaguesit, komuna nuk kishte ndërmarrë masa shtesë konkrete (përveç letrë rikujtimit) si ajo e veprimeve ligjore përmbanuesit për mbledhjen/realizimin e llogarive të</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur mekanizma adekuat me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.</p>	<p>Prokurimi</p> <p>Hapi parë Nxjerrja e raportit detal nga programi PR OFTAX 2002-2023.</p> <p>Hapi dytë Identifikimi i obliguesve AKP, subjekte Juridike ,gyretar.</p> <p>Hapi tretë Takime me palët obliguese (borgjlinjtë)</p> <p>Hapi katërt Veprimi konkret përmbanuesit ligjore Nga vërejtjet me shkrim deri në përmbanarin</p>	<p>Drejtoria Buxhet dhe Financa</p> <p>Menaxheri i zyrës Tatimit në Pronë</p>	<p>TM3 - TM4 2024</p>	<p>Ne Process</p>
----	--	---	---	--	---	-------------------------------	-------------------

	Arkëteshme.  Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin përkatës të arkëtimit e tyre.					
--	--	--	--	--	--	--

**Vërejtje:** Ky raport ka rezultuar me (tetë) 8 rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja dhe pestë (5) të përsëritura, rekomandimet me shkronjën A janë rekomandime të reja, ndërsa rekomandimet me shkronjën B janë të vitit paraprak.